

BIBLIOTEKA

E

JILDELS

844-1

S 66

GJIROKASTER

VEHBI  
SKËNDERI

Kumbojnë  
vitet

POEZI

8JH-1  
566

**VEHBI  
SKËNDERI**

**KUMBOJNË  
VITET**

**poezi**



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## NË KËTË TOKË

fragment

Në këtë tokë,  
ku kam me dhjetëra vjet që eci mes rrugëve të  
shkelura dhe vragave të ngrira,  
dhe hapi im s'është kompas, që të sajosh një  
rreth, po matës hapësirash,  
ku pikë e ujit lëshon dritë dhe nuk ka gur që  
të mos ndrijë,

ku s'di sa qytete të rinj janë vërsnikë me time  
bijë,  
ku s'i mendojmë depo bombash Hënën dhe Yllin  
e Mëngjesit.  
ku çdo thesar të këtij dheu e ka çdokush dhe tërë  
njerëzit,  
ku që nga një tarracë e Jonit vëren pinguinët  
në Artik,  
një baldazor mbi Kil' e vrenjtur, edhe një flu-  
turim kozmik.

Në këtë tokë,  
ku shkojnë çdo mëngjes në shkollë vogëlushët  
tërë gaz e zhurmë,  
(dhe gazin e tyre fëmijnor s'e nxënë sheshet  
edhe rrugët),  
ku ngazellehem si një fëmijë, edhe i shoqëroj  
përdore,  
ku gjithë ata që do të vijnë (stërnipët e  
stërmbesat) do të cicërojnë  
në gjuhën arbërore,  
dhe do të bien dhe do të ngrihen, duke gajasur e  
duke qarë,  
dhe do të hedhin nëpër oborr të stërmundimshmin  
çap të parë!

Në këtë tokë,  
ku vesa ndan ixhi luadheve, korijeve plot degë  
e fletë,  
ku sa kish dheu etje për shi, digjej zemra për të  
drejtën,  
ku nëna ime mbillte misrin pas gjurmëve nëpër  
çdo brazdë,  
ku kam takuar në çdo shteg urinë e sytë e saj  
të xhamtë,  
ku malarikët verdhacukë, mes zhelesh dridheshin  
në trokë.  
ku më ka vrarë gjumin, shpesh, mjerimi, si një  
shpellë e ftohtë,  
ku kam dëgjuar në habi ezanë e gjemën e  
kambanave,  
ku i kam mbajtur mbi kurriz gurët e rëndë të  
muranave.

Në këtë tolkë,  
ku shtrojmë ditë për ditë trase dhe ditë për ditë  
mbjellim pemë  
e mund të shkruash dhe me gjak, ti, më të  
bukurën poemë,  
ku shemben gjerdhe, mezhda e mure, edhe në  
hon gremisëm klasat

po lufta vlon dhe më e ashpër, se dalin kobrat,  
prapë, nga plasat,  
ku ju vret sytë dritë e diellit gjithë lakuriqve  
të natës,  
ku s'mund të shkelë dot Kizingeri, pëllumbi  
kafe i Nevadës,  
ku s'bjerim kohën me «debate», reklama e  
gjepura të kota  
dhe s'çajmë kokë për perëndi dhe as për zota e  
super zota,  
ku papa bubuzhel tremb sorrat në plantacione,  
kopshte e vreshta,  
ku dhe i madhi Skënderbe na flet me fjalët më  
të thjeshta.

Në këtë tokë,  
ku mund të rrish nën hijen e një peme dhe të të  
duket perna  
kaq e dashur,  
ku shkon të blesh në treg diçka me njerëzit edhe  
papritur ndihesh i pasur,  
ku përditë bëj dush nën shi e vesë dhe nën  
stërkala balte,

ku era s'bart veç pluhurin e rrugëve, po edhe një vështrim të afërt,  
ku s'janë mehur asnjë çast oshëtimat e gjëmimeve  
të hershme,  
ku ecim, çuditërisht, të sigurt sot dhe drejt ditëve  
të nesërme,  
ku dhjetëra vjet kositim drizë e ferra dhe prapë  
rrimë me kosor në dorë,  
ku çdo minutë ngremë diçka të madhërishme, por  
s'lypim gradë e varre madhështorë,  
ku lufta vlon dhe në përmasa planetare dhe bren-  
da një qelize,  
ku nuk lëvizin vetëm lumenjtë dhe trenat, por edhe  
malet janë në lëvizje.

Në këtë tokë,  
ku më pëlqejnë ngado shkoj dëbora, dielli edhe hija,  
ku thith me tërë mushkëritë ajër nga deti dhe korija,  
ku nuk ka gjë që nuk më dhimbset dhe e dua me gjithë prushin e zemrës  
deni te pikë e mbrame e gjakut dhe në pafundësinë e ëndrrës.

## **SHKALLËT E BREGDETIT**

Shkallë, për të parë brymën në një ledh si tretet,  
tek rrëzón me kazmë poplat poshtë.

Shkallë, për të folur mbrëmjes vonë me detet  
duke mbledhur fiq dhe yj në shpoortë.

Shkallë; ku blerimi nuk resht kurrë,  
ku lëshojnë aromë edhe gurët.

Shkallë për të thithur ajër në hapësirë,  
tek na ngre si driza flokët era.

Shkallë, që të shohim veten dhe më mirë;  
shkallë, të notojmë në blerim pérherë.

Shkallë, tek kuqlon dhe lulja, dhe fjala,  
shkallë, ku hedh shtat dhe fshati dhe qyteti  
dhe lidh syth e sotmja dhe përralla,  
dhe takohen tokë, qielli, deti...

Shkallë, të rrëmbejmë krahët e mëngjesit,  
mos të ngelet kund mendimi strukur.  
Shkallë, mos t'i zerë kurrë ndryshku njerëzit,  
shkallë, që të ngjitesh ti, rini e bukur!

## TURNET

Po marrim ca thërrime ngrice nëpër çizme,  
diçka nga ky acar që rrjep fytyrën,  
një guaskë akull mbi pelice  
dhe po ju lëmë në dorëzim  
detyrën.

E çfarë po ju lëmë vallë, shokë, tjetër?

Një lëmë-prush  
e dru — ç'na kanë mbetur.